



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1-27/2021
Datë 17.01.2024

Nr. 31/1 i vendimit
Datë 30.03.2026

VENDIM
PËR NDREQJE GABIMI

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 30.03.2026, ditën e hënë, në orën 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, kërkesën për ndreqjen e gabimit material në vendimin me nr. 31 (JR), datë 18.07.2023, me:

KËRKUESE: Klodiana Gjyzari

OBJEKT: Ndreqja e gabimit material në vendimin nr. 31 (JR), datë 18.07.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari.

BAZA LIGJORE: Neni 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar; neni 312, paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi, kërkesën e znj. Klodiana Gjyzari, për ndreqjen e gabimeve materiale në vendimin nr. 31 (JR), datë 18.07.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket kërkueses në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), me vendimin nr. 31 (JR), datë 18.07.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 340, datë 01.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari.
2. Pas komunikimit të këtij vendimi, znj. Klodiana Gjyzari ka konstatuar gabime në shkrim të bëra në vendim dhe, me anë të shkresës së regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 17.01.2024, ka kërkuar që, bazuar në nenin 312 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues të ndreqë gabimet e konstatuara prej saj.
Znj. Klodiana Gjyzari, në kërkesën e saj, ka evidentuar se nga një lexim i vendimit ka konstatuar se:
 - 2.1. Në paragrafin 30.5, nënndarja “(a)” të tij, është referuar gabim vlera e të ardhurave personale nga puna e z. E. Gj., të pasqyruara nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003. Nga subjekti i rivlerësimit këto të ardhura janë deklaruar në vlerën “1.100.000 lekë”, ndërsa në vendim është referuar vlera “100.000 lekë”.
 - 2.2. Në paragrafin 32.3, është referuar se “Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë të njëjtin mjet nga z. S., vetëm tri ditë më vonë”, fakt ky që vjen në kundërshtim me praktikën doganore së cilës i është referuar Kolegji, pasi pagesa nuk është kryer tri ditë më vonë, por një vit e gjysmë pas pagimit të detyrimit doganor.
3. Trupi gjykues, pasi u njoh me këto gabime në shkrim, vlerësoi se situata është pikërisht ajo që rregullohet nga neni 312 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *“Pas shpalljes së vendimit, gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo me kërkesën e palëve ose kryesisht mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit. [...]”*, që legjitimon gjykatën të ndreqë gabimet me kërkesë të palëve. Kolegji vlerëson se zbatimin e nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile e dikton parashikimi i nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, dispozita të cilat orientojnë Kolegjin në aplikimin e normave të Kodit të Procedurës Civile, në rast se situatat ligjore të prezantuara për zgjidhje nuk gjejnë një zgjidhje të posaçme nga vetë ligji nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues, në përfundim, çmoi se duhet të bëhet korrigjimi i gabimeve në shkrim, si vijon:
 - 4.1. Në paragrafin 30.5, nënndarja “(a)”, togfjalëshi “në shumën 100.000 lekë”, zëvendësohet me togfjalëshin “në shumën 1.100.000 lekë”.
 - 4.2. Në paragrafin 32.3, në fjalinë “Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë të njëjtin mjet nga z. S., vetëm tri ditë më vonë, në datën 22.06.2010, në shumën 250.000 lekë, fakt ky i mjaftueshëm për Komisionin për të arritur në përfundimin se z. Gj. e ka blerë pasurinë objekt kontrolli në kushtet e trajtimit preferencial”, togfjalëshi “vetëm tri ditë më vonë” fshihet.
5. Trupi gjykues vlerësoi se me anë të ndreqjes së këtyre gabimeve nuk ndryshohet vullneti i Kolegjit, i formuar me rastin e dhënies së vendimit që konkretizohet me shpalljen e tij, dhe as nuk preket përmbajtja e dispozitivit të vendimit nr. 31 (JR), datë 18.07.2023.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në zbatim nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 312, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Ndrejken e gabimeve në shkrim në arsyetimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 18.07.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket kërkuases Klodiana Gjyzari, si më poshtë.
 - Në paragrafin 30.5, nënndarja “(a)”, togfjalëshi “në shumën 100.000 lekë”, zëvendësohet me togfjalëshin “në shumën 1.100.000 lekë”.
 - Në paragrafin 32.3, në fjalinë “Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë të njëjtin mjet nga z. S., vetëm tri ditë më vonë, në datën 22.06.2010, në shumën 250.000 lekë, fakt ky i mjaftueshëm për Komisionin për të arritur në përfundimin se z. Gj. e ka blerë pasurinë objekt kontrolli në kushtet e trajtimit preferencial”, togfjalëshi “vetëm tri ditë më vonë” fshihet/hiqet.
2. Ky vendim i bashkohet vendimit nr. 31 (JR), datë 18.07.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.03.2026.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi